



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E VËZHguesVE AFATGJATË TË INSTITUTIT DEMOKRATIK
AMERIKAN (NDI) NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i vëzhguesve afatgjatë të Institutit Demokratik Amerikan (NDI) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor, 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Instituti Demokratik Amerikan është një organizatë jo-fitimprurëse, jopartiake, joqeveritare që i përgjigjet aspiratave të njerëzve në mbarë botën për të jetuar në shoqëri demokratike që njohin dhe promovojnë të drejtat bazë të njeriut.



Nr. 835 i Vendimit **Data 12 .06.2019** **Ora 13 .⁰⁰ e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Institutit Demokratik Amerikan (NDI) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor,

2019

NDI punon në Shqipëri që nga viti 1991, duke nxitur rritjen e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje në nivel lokal dhe kombëtar, duke organizuar dhe mbështetur monitorimin e zgjedhjeve, edukimin e votuesve dhe duke nxitur zhvillimin e partive politike dhe liderëve të rinj.

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatgjatë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Institutit Demokratik Amerikan (NDI), për akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatgjatë, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 835 i Vendimit **Data 12 .06.2019** **Ora 13 .⁰⁰ e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Institutit Demokratik Amerikan (NDI) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor,

2019